

## **Analiza vjetore 2022, për Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit, Drejtorinë e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Shërbimit IT, Drejtorinë e Shërbimeve dhe Sektorin e Financës**

Në datën 3 shkurt 2023, u zhvillua në mjediset e KLSH-së, analiza vjetore e punës për vitin 2022, e Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit, Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Shërbimit IT, Drejtorisë së Shërbimeve dhe Sektori i Financës.



Në përmbledhje të punës për vitin 2022, pjesëmarrësit u njohën me realizimin e objektivave strategjike dhe operacionale për çështje me ndikim në forcimin e kapaciteteve audituese. Gjithashtu, viti 2022 përkoi me vitin e fundit të Strategjisë 5-vjeçare të KLSH-së, ndaj ky vit gjithashtu kulmoi me hartimin dhe publikimin e Strategjisë së re të Zhvillimit institucional 2023-2027, por edhe të dokumenteve të tjerë të rëndësishëm, të cilët u hartuan në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtare SIGMA dhe IDI, si Raporti i Vetëvlerësimit të KLSH-së, Strategjia e Komunikimit të KLSH 2022-2025, Manuali i Auditimit të OZHQ-ve, etj.

Me synim shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të stafit, ka vijuar intensifikimi i bashkëpunimit me SAI-et homologe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjella si me SAI-n e Norvegjisë dhe të Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrjes në aktivitete, takime, trajnime, etj, si dhe zhvillimit të auditimeve paralele në kuadër të anëtarësimit në grupet e punës së EUROSAT-t.

Qëllimi i një SAI është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë.

Gjatë vitit 2022 pavarësisht sulmeve kibernetike të ndodhura në vendin tonë, infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe rrjeti TI ka operuar në gjendje funksionale në përputhje me kërkesat e “trekëndëshit CIA”.



Në vitin 2022, janë zhvilluar 280 aktivitete trajnuese të brendshme dhe të jashtme për zhvillimin profesional të stafit auditues.

Në kuadër të misionit të transparencës, mbrojtjes së interesit publik dhe rritjes së besimit të qytetarëve tek institucioni, KLSH ka trajtuar brenda afateve çdo kërkesë për informacion ose ankesa drejtuar institucionit.

Përmes komunikimit të vazhdueshëm, KLSH ka ndjekur në vijimësi një politikë të hapur dhe bashkëpunuese me median, për të garantuar një institucion të pavarur dhe të besueshëm. Përgjatë vitit 2022, veprimtaria e KLSH është trajtuar gjerësisht në media, e cila konsiderohet si një ndër partnerët e rëndësishëm strategjik të institucionit për pasqyrimin në kohë dhe promovimin e aktivitetit auditues.

Në përmbyllje, z. Preçi, duke vlerësuar veprimtarinë e realizuar në vitin 2022, kërkoi vëmendje të shtuar për përmirësimin e vazhdueshëm të punës dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë.